



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 30.

Prishtinë, më 6.02.2012 në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

ROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Munguan: Elmi Reçica, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca dhe Petar Miletic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: Lejla Selimi -OSBE, Shkumbim Beqiri - KDI, Visar Bivolak – EULEKS, Ukë Gashi – ZPRK dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës me rekomandimin e Nënkomisionit për Mandate dhe Imunitetet të rregullores së Kuvendit

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e vetëm një pike të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës me rekomandimin e Nënkomisionit për Mandate dhe Imunitetet të rregullores së Kuvendit

Kryesuesi- theksoi se në mbledhjen plenare të mbajtur me 23 janar 2012, Kuvendi ka shqyrtuar dhe miratuar në parim Projektregullorën e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të kushteve të caktuara me Rregullore, Komisioni është i autorizuar të shqyrtojë propozim ndryshimet e Projektregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës të hartuar nga Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ai kërkoi që anëtarët të deklarohen nëse ka vërejtje eventuale në raportin e komisionit funksional.

Myfera Sinik- theksoi se gjatë shqyrtimit të Projektregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës , grupit parlamentar 6+, vërejtjet e vetat i ka paraqitur me shkrim në nënkomisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit dhe shtoi se të njëjtat janë inkorporuar në raportin e komisionit funksional.

Kryesuesi - konstatoi se Komisioni për Komunitete dhe kthim në mbledhjen e mbajtur më 6.02.2012, me shumicë të votave miratoi Raportin e Projektregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës , dhe nxori këtë:

Përfundim

- I. Projektregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim ka shqyrtuar propozim ndryshimet e Komisionit funksional dhe ka konstatuar që të njëjtat nuk cenojnë dhe nuk shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Të ndryshme

Kryesuesi- e njoftoi komisionin se në kuadër të ftesës së komisionit për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, është caktuar që me datën 9.02.2012, të mbahet takim i përbashkët me Komisionin për Komunitete. Si pikë e rendit të ditës është caktuar shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Hoça e Madhe.

Theksoi se komisioni e ka përfunduar punën e vet dhe i ka votuar në mënyrë unanime amendamentin 11, të komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës Njëherit i ka rekomanduar Kuvendit që të miratojë projektligjin me amendamentet e përkrahura

Ai kërkoi që komisioni në përbërje të plot të merr pjesë në këtë takim, në kontekst të rishikimit të kërkesës së komisionit për bujqësi.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic